| | | |
|---|---|---|
| | **REPUBLIKA E KOSOVËS**<br>REPUBLIKA KOSOVA<br>REPUBLIC OF KOSOVA<br>**KOMUNA E RAHOVECIT**<br>OPSTINA ORAHOVAC<br>MUNICIPALITY OF RAHOVEC | |

| | |
|---|---|
| **Për:** | **Grup i Operatorëve Ekonomik: Horn & Co. Kosova SH.P.K.; Asfalti SH.P.K., fshat Lëbushë me adresë në Deçan**<br><br>**Operatorëve Ekonomik**<br><br>**Të gjitha palëve të interesuar** |
| **Nga:** | **Astrit Mullabazi**, Menaxher i Zyrës së Prokurimit |
| **Lënda:** | **VENDIM** për Rishqyrtim të Kërkesës |
| **Datë:** | **12.10.2021** |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **11.10.2021**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **Horn & Co. Kosova SH.P.K.; Asfalti SH.P.K., fshat Lëbushë** me adresë në **Deça,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RRËNIMI I OBJEKTEVE PA LEJE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-5827-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-053-5-2-1**, nxjerr:

## VENDIM

**I.** **REFUZOHET** e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **Horn & Co. Kosova SH.P.K.; Asfalti SH.P.K., fshat Lëbushë** me adresë në **Deça,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RRËNIMI I OBJEKTEVE PA LEJE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-5827-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-053-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **06.10.2021**, të publikuar në web – faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net.

**II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RRËNIMI I OBJEKTEVE PA LEJE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-5827-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-053-5-2-1**.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net.

## A R S Y E T I M

Grup i Operatorëve Ekonomik: **Horn & Co. Kosova SH.P.K.; Asfalti SH.P.K., fshat Lëbushë** me adresë në **Deça,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RRËNIMI I OBJEKTEVE PA LEJE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-5827-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-053-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **06.10.2021**, të publikuar në web – faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **11.10.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

## BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

**PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:**

1. Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik ne piken 11.1, **Ne ketë kërkesë marrëveshja e Grupit te operatoreve ekonomik për te lidhur ketë grup me te gjitha flete përcjellës është e skanuar nga kopja e dokumenteve e jo nga origjinali.** Bashkangjitur dokumentat e skanuar nga kopja.

**PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:**

**Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar**, sepse bazuar ne RrUOPP si dhe se fundmi tek Pyetjet & Përgjigjet nga KRPP-ja, kjo situatë e mungesës së nënshkrimit elektronik sqarohet shumë qartë në interpretimin ne vijim te hijezuar:

***55. 31.08.2017. Si të veprohet në rastet kur lista e çmimeve jo-standarde gjatë përdorimit të platformës elektronike nuk nënshkruhet dhe vuloset nga Operatorët Ekonomik? (Referoju RRUOPP)***

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Gjate hartimit te dosjes së tenderit, autoriteti kontraktues mund të përdorë dy lloje të Listës se Çmimeve:

-Listën e Standardizuar

-Listën e Jo-standardizuar

Nëse autoriteti kontraktues përdor Listën e Çmimeve "standarde" (formularin nga sistemi), operatori ekonomik ka në dispozicion dy opsione për të shënuar çmimet e ofruara:

a) Shënimi i çmimeve ne mënyre manual në formën e siguruar nga sistemi ku vendoset çmimi për njësi dhe norma e TVSH-ës për çdo artikull.

b) Shkarkon dokumentin Excel Lista e Çmimeve (nga ekrani i Njoftimit të Kontratës), plotëson atë dhe ngarkon përsëri në sistem.

Në rast se përdoret lista e çmimeve e standardizuar**çmimi total**llogaritet automatikisht nga norma e çmimeve për njësi, sasisë dhe të TVSH.

**Në mungesë të nënshkrimit elektronik Lista e çmimeve standarde nuk mund të nënshkruhet nga Operatorët Ekonomik.**

Në rast se lista e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndryshme) të AK, AK mund të krijoj një listë te re, pra listën e çmimeve **jo standarde.**

Nëse Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur Listën e Çmimeve Jo te Standardizuar , atëherë Lista e Çmimeve si pjesë e Dosjes se Tenderit duhet të ngarkohet si dokument.

Lista e Çmimeve mund të jetë në forma të ndryshme (Word, Excel, PDF).

Përveç ngarkimit te Listës se Çmimeve, përdoruesi (OE) **duhet të shënoj çmimin total të ofertës** (çmimet nuk mund të nxirren në mënyrë automatike në këtë rast, për shkak se formati i Listës se Çmimeve **jo i standardizuar** nuk është i mandatuar nga sistemi).

**Si pasoj e mungesës së nënshkrimit elektronik sikurse çdo dokument tjetër i përmendur në nenin 33 (Dorzimi elektronik i tenderëve) edhe lista e çmimeve** jo standarde **mund por nuk është e domosdoshme të nënshkruhet dhe të vuloset nga Operatorët Ekonomik.**

Sidoqoftë situata e potencuar më lartë nuk vlen për dorëzimin fizik të ofertave për të cilat situata neni 39 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ duhet aplikuar si tersi.

**Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.**

**<u>PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:</u>**

2. Ne piken 6.4 Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmia 1 Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes) – **Gjate kontrollit te këti dokumenti shihet se njeri nga operatoret Dardaniaa SH.P.K këtë dokument e ka te skanuar nga kopja e jo nga origjinali.** Bashkangjitur dokumentin e skanuar nga kopja.

**<u>PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:</u>**

**<u>Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar</u>**, dhe potencojmë që të lexoni përgjigjen ne pretendimin ankimor nr. 1 që është i njëjti.

**PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:**

> 3. Ne piken 7.1&7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së – **Ne këtë kërkesë mungon Çertifikata e tvsh-së e dy operatoreve ekonomik AEK MUNELLA SHPK;DARDANIAA SHPK ndërsa operatori AGRO INVEST 1 SHPK qe e posedon e ka Çertifikata e tvsh-së e ka te vjetruar.** Bashkangjitur dokumentin e skanuar nga kopja.

**PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:**

**Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar**, pasi që gjatë vlerësimit të ofertave, AK: Komuna e Rahovecit, ka verifikuar ne linkun: https://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/Index, sipas se cilit ka ardhur ne përfundim se Operatori Ekonomik: DARDANIAA SHPK, është Deklarues i TVSh-së, shih dokumentin nga ATK-ja:


Kërko tatimpaguesin

Nr. Fiskal / NRB / Nr. TVSh: 811289843

I'm not a robot
reCAPTCHA
Privacy - Terms

Kërko

Nr. Fiskal / NRB: 811289843 | 811289843

Emri: DARDANIAA SH.P.K.

Adresa: BEDRI SHALA,.

Qyteti: PRISHTINË

Komuna: PRISHTINË

Qendra Tatimore: PRISHTINË 2

Nr. TVSh: 330418386

Statusi në TVSh: DEKLARUES I TVSH

© 2013 - Administrata Tatimore e Kosovës

**<u>Për Operatorin Ekonomik: AEK MUNELLA SHPK</u>**, gjeni linkun: https://opencorporates.al/sq/nipt/j98926001p për Certifikatën e TVSh-së

Ndërsa sa i përket pretendimit tuaj, kemi verifikuar ne linkun: https://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/Index, sipas se cilit ka ardhur ne përfundim se Operatori Ekonomik: AGRO INVEST 1 SHPK, është Deklarues i TVSh-së, shih dokumentin nga ATK-ja dhe ka te njëjtin Nr. të TVSh-së si në Certifikatën e prezantuar ashtu edhe ne linkun e bashkangjitur:

## Kërko tatimpaguesin

Nr. Fiskal / NRB / Nr. TVSh

811034280

I'm not a robot — reCAPTCHA Privacy - Terms

Kërko

| | | |
|---|---|---|
| Nr. Fiskal / NRB | 811034280 | 811034280 |
| Emri | AGRO INVEST 1 SH.P.K. | |
| Adresa | p.n. | |
| Qyteti | MUSHTISHTË | |
| Komuna | SUHAREKË | |
| Qendra Tatimore | PRIZREN 1 | |
| Nr. TVSh | 330260993 | |
| Statusi në TVSh | DEKLARUES I TVSH | |

© 2013 - Administrata Tatimore e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

ÇERTIFIKATË - DEKLARUES I TVSH
UVERENJE - OBVEZNIK ZA PDV
CERTIFICATE - VAT FILER

| | |
|---|---|
| Numri<br>Broj<br>Number | 330260993 |
| Numri fiskal<br>Fiskalni broj<br>Fiscal Number | 601229877 |
| Emri i Personit<br>Ime Osobe<br>Person's Name | " AGRO INVEST 1 " SH.P.K. |
| Adresa e Personit<br>Adresa Osoba<br>Person's Address | Republika e Kosovës,Suhareka,Mushtishtë (p.n.) |
| Data e Regjistrimit<br>Date of Registration<br>Datum Registracije | 16/03/2015 |
| Data e Lëshimit<br>Datum Izdavanja<br>Date of Issue | 16/03/2015 |
| Personi Përgjegjës<br>Odgovorno Lice<br>Responsible Person | |

Kjo çertifikatë është lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi vlerën e
Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno Zakona Br. 03/L-146 O Porezu na Dodanu Vrednost.
This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on the Law Nr. 03/L-146 on Value Added Tax.

VERSIONI - 6 - KORIGJUAR 03-05-2011

**<u>PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:</u>**

4.Ne piken 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne

Kërkesa 1 Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani.-**Ne këtë pik kontrata e punëtoreve gjinden te nënshkruar vetëm nga operatori ekonomik e jo nga punëtoret.** Bashkangjitur dokumentin e skanuar nga kopja.

**<u>PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:</u>**

**<u>Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar</u>**, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar listën e punëtorëve/stafit teknik, në të cilat janë te prezantuar stafi i përhershëm, stafi menaxherial dhe të punëtorëve prej: **13 punëtor të nënshkruar dhe te vulosur nga Operatori Ekonomik**, ne pajtim me Kërkesën 1 / Dëshminë 1, të Kapacitetit teknik dhe profesional sipas FDT-së, e cila e tejkalon numrin e kërkesës tonë.

**<u>PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:</u>**

Kërkesa 2 Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 6 vite pas diplomimit- **Ne këtë pikë shihet qart se Menaxher i projektit ne listën e stafit te kompanisë është ing. Fisnik Berisha ndërsa dokumentat e vendosur te menaxheri i projektit janë ing. Safet Lipovica ku diploma e ti është e moterizuar me datën 29.06.2018** Bashkangjitur dokumentin e skanuar nga kopja.

**<u>PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:</u>**

**<u>Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar</u>**, pasi që ju po përqendroheni te lista e punëtorëve/stafit teknik të prezantuar nga Operatori Ekonomik i sugjeruar për kontratë, që nënkupton se ata janë detyrat aktuale te stafit te prezantuar ne kompaninë e tij.

Për sa i përket kërkesës së mësipërme, Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar Menaxherin e Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 6 vite pas diplomimit, ne pajtim me Kërkesën 2 / Dëshminë 2, të Kapacitetit teknik dhe profesional sipas FDT-së e cila nuk ka të bëjë me përshkrimin e detyrës se stafit tjetër te listës së punëtorëve.

Po ashtu sipas Ligjit: **<u>LIGJI NR. 03/L-010 PËR NOTERINË</u>**, nuk ceket Validiteti i noterizimit te dokumentacioneve, andaj noterizimi është i paafatshëm.

**<u>PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6:</u>**

Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 115,000.00 €uro – **Ne ketë Kërkesë gjate kontrollit shihet qart se nuk kanë pune te ngjashme për 3 vitet te fundit, Ato qe i kanë ju mungon Referenca/Procesverbali këtë mund ta shinin ne dosjen e tenderit.**

**PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6:**

**Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar**, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar listën e projekteve dhe ka bashkangjitur Referencat te natyrës se punëve te ngjashme, ku gjeni te bashkangjitur vetëm 2 nga 4 Referencat e prezantuara nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, te cilat i keni pasur gjatë qasjes ne dokumentacion dhe përsëri keni dyshime:

Mushtisht-Therandë
AGRO -INVEST-1

**Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit**

**(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)**

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | Nurmi i telefonit te Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Rrenimi i objekteve te ndertuara pa leje – procedure emergjente | 09/12/2019 | 09/03/2020 | 31'480.00 € | KK Prishtinë | |
| 2. | Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje Nr.Prokurimit 616-17-064-5-2-1 | 22/09/2017 | 12/10/2018 | 75'450.00 € | KK Prishtinë | |
| 3. | Rrënimi i strukturavetë pa lixhshme të ndërtuara në pronat private sipas Ligjit 05/L010 | 22/01/2019 | Aktive | 65'313.00 € | Agjensia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës | |
| 4. | Grumbullimi, transporti dhe trajtimi i mbeturinave inerte | 07/09/2020 | 20/05/2021 | 174'000.00€ | KRM "Pastrimi" SHA Prishtinë | |

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik ____________

Vula ____________ SH P K AGRO INVEST 1 MUSHTISHTE-SUHAREKE

Kontratat e realizuara nga operatori "Agro Invest – 1" Sh.p.k Fleta 1

Referenca e dorëzuar nga Operatori Ekonomik, e natyrës së njëjte (sipas titullit të projektit):

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

| | |
|---|---|
| Datë/a: | 12.10.2018 11. 11. 2018 |
| Referencë: | 616-17-064-5-2-1 dt.22.09.2017 |
| Për/ Za/ To: | N.P.N "Dardania" |
| CC: | Qendra për shërbim me qytetarë |
| Përmes/Preko/Through: | Brahim Mehmetaj-Drejtor i Drejtorisë së Inspekcionit |
| Nga/ Od/ From: | Lorik Zhubi, Inspektor i Ndërtimit- Menaxher i Projektit |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Referencë mbi punët e zhvilluara |

Me anë të kësaj Reference konfirmohet se Operatori Ekonomik: **N.P.N "Dardania"**, adresa **Prishtinë, Jon Kukuzeli** nr.35,përfaqësuar nga **Behram Gashi** me **Komunën e Prishtinës** ka nënshkruar kontratën:
**"Rrënimi i objekteve të** ndërtuara pa leje" me numër identifikues: **616-17-064-5-2-1 dt.22.09.2017 dhe me vlerë totale** indikative të kontratës prej **75,450 € (Euro)** me devijim të lejuar nga vlera **totale indikative +- 30%.**

Realizimi I punëve është kryer sipas kritereve, afateve, kushteve dhe standardeve të parapara në kontratë.

Konsiderojmë se Operatori Ekonomik N.P.N **"Dardania"**, ka aftësinë e duhur për përmbushjen e kontratave të kësaj natyre prandaj edhe e rekomandojmë te punëdhësit tjerë.

**T,IU dërgohet :**
**- Menaxherit të kontratës,**
**- Qendra për shërbim me qytetarë,**
**- Palës,**

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://ëëë.prishtina-komuna.org

Referenca e dorëzuar nga Operatori Ekonomik, e natyrës së ngjashme (e njëjte sipas përshkrimit te punës):

KOMPANIA REGJIONALE PASTRIMI PRISHTINË

**K.R.M.''PASTRIMI''SH.A.**

**PRISHTINË**

# Refrencë

Përmes kësaj Reference konfirmoj se **K.R.M. "Pastrimi " Sh.A.Prishtinë** si Autoritet Kontraktues në njërën anë dhe Furnitori :**Operatori Ekonomik"** ***AGRO INVEST " SH.P.K-Suhareke,*** me perfaqësues Avdi Jakupi si kontraktues në anën tjetër me datën 07.09.2020, kanë nënshkruar kontratën dhe me numër Prokurimi : **PAS -20-038-2-1-1 dhe Vete Financim 20-2812-221,** Titulli:"**Grumbullimi ,Transporti dhe Trajtimi i Mbeturinave Inerte",** në vlerë prej **174000.00€** si kontraktues me përpikmeri dhe me një profesionalizëm të lartë i ka përmbushur të gjitha obligimet e kontratës.

**Operatori Ekonomik** ***'SH.P.K.. "AGRO INVEST", Suhareke.***

Andaj të gjitha Autoriteteve Kontarktuese që kanë nevojë për:

**Grumbullimi dhe Transport i Mbeturinave Inerte,** ju rekomandojmë që **Operatorit Ekonomik** ***'Agro Invest,*** ti ofrojni bashkpunim në të ardhmen.

Referenca lëshohet me kërkesën e: **Operatorit Ekonomik** ***'SH.P.K.AGRO INVEST", SUHAREKE".***

**Prishtine 20.05.2021**

Me respekt,

Zyra e Prokurimit

**Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.**

**<u>PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 7:</u>**

Kërkesa 5 Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Tre (3) Kamion kiper – **Ne ketë kërkesë librezat e qarkullimit nuk shihen kjartë edhe disa prej tyre ju mungon edhe regjistrim gjë qe janë te pa regjistruara qe nga viti 03.12.2015.** Bashkangjitur dokumentin e skanuar nga kopja.

---

**<u>PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 7:</u>**

**<u>Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar</u>**, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar librezat e qarkullimit te automjeteve, te cilat i keni pasur gjatë qasjes ne dokumentacion dhe përsëri keni dyshime:

Gjeni te bashkangjitur librezat e qarkullimit te automjeteve, te cilat pretendoni se nuk shihen qartë sipas kërkesës tuaj, po ju bashkëngjisë edhe njëherë për qartësi:







**Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.**

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

**KËSHILLË JURIDIKE**:

Kundër këtij **vendimi të AK–së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP–së në pajtim me nenin 109 të LPP–së. Ankesa pranë OSHP–së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit